STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 21 shkurt 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE DEPARTAMENTI I SHERBIMEVE FINANCIARE (DEPARTMENT OF FINANCIAL SERVICES) PO HETON SIGURUESIT PER PRAKTIKA TE PAPRANUESHME MBI KERKESAT QE KANE LIDHJE ME STUHINE SENDI (SANDY)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Departamenti i Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) është duke hetuar praktikat mbi kërkesat e tre siguruesve pas stuhisë Sendi (Sandy). Të tre, Narragansett Bay Insurance Company, Tower Insurance Company dhe Kingstone Insurance Company, kanë patur ankesa shumë më të larta sesa mesatarja nga konsumatorët tek Departamenti.

Siguruesit po hetohen për (1) mos-dërgimin e inspektorëve në kohë, (2) mos-përpunimin e kërkesave në kohë, dhe (3) mos-lejimin që pronarët e shtëpive të kontaktojnë me përfaqësuesit e ndërmarrjes së sigurimit. Shteti i Nju Jorkut (New York State) ka rregjistruar numrin e ankesave kundër siguruesve dhe është duke botuar kartelat e azhornuara të raportimit që vlerësojnë rendimentin e ndërmarrjeve të sigurimit në reagimin ndaj katastrofës dhe në pagimin e kërkesave në www.NYInsure.ny.gov.

"Eshtë thelbësore që njerëzit shtëpitë e të cilëve u dëmtuan ose u shkatërruan nga stuhia Sendi (Sandy) të marrin sigurimin për të cilin kanë të drejtë sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që të kthehen në shtëpitë e tyre dhe të fillojnë rindërtimin," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Kemi punuar me industrinë e sigurimit për të lehtësuar rregullat dhe falënderoj ndërmarrjet që janë përgjigjur. Por nuk do të tolerojmë siguruesit që të mos bëjnë atë që pronarët e shtëpive i paguan që të bëjnë—të përgjigjen shpejt në një katastrofë."

Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky), Kryeinspektor i Shërbimeve Financiare (Superintendent of Financial Services), tha, "Këto praktika dhe vëllimi i ankesave për kërkesat e patrajtuara janë krejtësisht të papranueshme. Mbajtësit e policave të Nju Jorkut (New York) kanë bërë pagesat e tyre dhe kanë çdo të drejtë që të presin një përpunim në kohë të kërkesave të tyre në mënyrë që të mund të rindërtojnë shtëpitë dhe bizneset e tyre. E dimë se stuhia krijoi rrethana të jashtëzakonshme, por gjithsesi presim që siguruesit të veprojnë në përputhje me standartet më të larta."

Departamenti është duke hetuar praktikat mbi kërkesat e tre siguruesve duke dërguar një letër sipas Pjesës 308 të Ligjit mbi Sigurimin, që është një kërkesë për informacion, të cilës siguruesve u kërkohet me ligj që t'i përgjigjen.

Mbajtësit e policave të Narragansett shpesh janë ankuar se nuk kanë qënë në gjendje të kontaktojnë me inspektorët ose se inspektorët nuk kanë shkuar në takimet e planifikuara. Disa pronarë të shtëpive ishin veçanërisht të shqetësuar sepse kishin pritur me javë për takimet dhe kishin marë leje nga puna për t'u takuar me inspektorët, vetëm për të mësuar se inspektorët anulluan takimet me njoftim pak kohë më parë ose pa njoftim.

Ankesat në lidhje me Tower Insurance krijojnë përshtypjen se ndërmarrja është përfshirë në një metodë të mos-dërgimit të inspektorëve për të kontrolluar pronat e dëmtuara. Shumë banorë të Nju Jorkut patën vështirësi në planifikimin e një kontrolli me Tower, ndërsa të tjerëve u janë mohuar kërkesat në telefon pa një vizitë të inspektorit. Departamenti gjithashtu ka marë disa ankesa nga mbajtësit e policave të Tower se nuk ishin në gjendje të kontaktonin me një përfaqësues të ndërmarrjes, se ndërmarrja ka vonuar përpunimin e kërkesave të konsumatorëve dhe se ndërmarrja ka mohuar kërkesat në mënyrë të padrejtë sipas miratimit të bllokimit të ujrave të zeza.

Ankesat kundër Kingstone kanë lidhje me dështimin nga ndërmarrja për të dërguar ose për të dërguar në kohë një inspektor; dërgimin e një inspektori që kontrolloi një pjesë të pronës (për shembull, vetëm dëmtimin e çatisë dhe jo dëmtimin brenda pronës); mohimin e kërkesave për dëmtime nga era; shuma të diskutuara të zgjidhjeve; dhe zgjidhje të vonuara.

Rregullorja 64 e Sigurimeve e Nju Jorkut kërkon që prona e dëmtuar të kontrollohet brenda 15 ditëve të biznesit nga paraqitja e një kërkese, por për disa viktima të stuhisë Sendi (Sandy) koha e kontrollit u shkurtua më 29 nëntor 2012 në gjashtë ditë të biznesit.

Përveç kësaj, siguruesve u kërkohet të marrin një vendim mbi një kërkesë brenda 15 ditëve të biznesit nga përfundimi i hetimit të kërkesës. Nëse nuk janë në gjendje që të përmbushin atë afat kohor, siguruesve u kërkohet t'u dërgojnë një letër pronarëve të shtëpisë duke shpjeguar arsyen për vonesën. Departamenti është duke u kërkuar siguruesve që të japin informacion sesa letra të zgjatjes janë duke dërguar, arsyet e dhëna për nevojën e zgjatjes dhe kohën e parashikuar për përfundimin.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418